



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA

MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR  
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

KËSHILLI KONSULTATIV  
QEVERISJE QENDRORE - VETËQEVERISJE VENDORE

Nr 362 prot

Tiranë, më 28.05 2024

VENDIM

Nr. 3 datë 28.05 2024

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTAKTEVE OBJEKT KONSULTIMI NË MBLEDHJEN E  
KËSHILLIT KONSULTATIV, QEVERISJE QENDRORE – VETËQEVERISJE  
VENDORE TË DATËS 23/5/2024


Këshilli Konsultativ bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe në VKM nr.244, datë 17.4.2024 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”, pas shqyrtimit të projektakteve të mëposhtme, të mbledhjes së datës 23.5.2024 vendosi:

1. Për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.867, datë 10.12.2014, “Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore”, propozuar nga Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, anëtarët e Këshillit Konsultativ u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
  - Bazuar në Ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 10, NJVV-të mund të lidhin një marrëveshje ku mund të listohen të gjitha pikat e bashkëpunimit drejtpërdrejt ASHK-së pa patur nevojë për një projektvendim;
  - Të qartësohen detyrat midis dy institucioneve ASHK-së dhe NJVV-ve;
  - Të përcaktohen qartë afatet kohore të procedurave;

- Pika 4 e projektvendimit ku “ASHK-ja dhe bashkia vlerësojnë nevojën dhe mundësitë reale për realizimin të këtij bashkëpunimi, duke përfshirë burimet njerëzore dhe financiare në dispozicion me qëllim trajtimin me prioritet dhe përmbylljen e procesit sipas afatit të përcaktuar në marrëveshje”, referuar nenit 21, pika 3, Ligji 139/2015 funksionet që delegohen pushtetit vendor duhen shoqëruar me financat përkatëse;
  - Të saktësohet mekanizmi për nxitjen e procesit pasi mungojnë afatet dhe lista që pritet të dërgohet nga NJVV-të nuk trajtohet si prioritet;
  - Të përcaktohet forma detyruese/masat që do të ndërmerren në rast moszbatimi të marrëveshjes;
  - Të faktohet bashkëpunimi real mes bashkisë dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.
2. Për projektligjin **“Për një ndryshim në ligjin nr.35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”**”, propozuar nga Kryeministria, anëtarët e Këshillit Konsultativ u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
- Të qartësohet ndryshimi i pagave për kryetarët e fshatrave në 10%, nëse ky buxhet do të vijë me rritjen e pagave apo do të vijë nga vetë bashkitë.
3. Për projektvendimin **“Për rregullat e zbatimit mbi kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale”**, propozuar nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, anëtarët e Këshillit Konsultativ u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
- Të qartësohet nëse në sipërfaqen e përgjithshme funksionale të objektit të banimit do përfshihen/llogariten dhe ambientet e përbashkëta si shkalle etj.
4. Për projekturdrin **“Për miratimin e rregullores për standardizimin dhe administrimin e shtigjeve turistike”**, propozuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, anëtarët e Këshillit Konsultativ mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim me projekturdrin.
5. Për projektudhëzimin **“Për Procedurat e dhënies në përdorim të përkohshëm të territoreve të kullotave, pjesë e zonave të mbrojtura”**, propozuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, anëtarët e Këshillit Konsultativ mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim me projektudhëzimin.
6. Për projektvendimin **“Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për dhënjen me qera të tokave jo bujqësore shtetërore”**, propozuar nga , Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, anëtarët e Këshillit Konsultativ u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
- Të zgjerohet objekti i këtij akti duke shtuar edhe tokat bujqësore, kullotat dhe pyjet.

7. Për projektudhërin nr.199, datë 07.05.2024, “Korniza e vlerësimit të cilësisë së kopshtit” dhe
8. Për projektudhëzuesin metodologjik për realizimin e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të kopshtit”, propozuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit anëtarët e Këshillit Konsultativ mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim me projektudhërin dhe projektudhëzuesin.

**Z. Arbjan MAZNIKU**  
Ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor  
Bashkëkryetar



**Z. Aldrin DALIPI**  
Kryetar i Shoqatës së Këshillit  
të Qarqeve të Shqipërisë  
Bashkëkryetar

